



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 4 , Datë 18.12. 2012

Për

Projekt-idenë e objektit “Rehabilitimi i Pjesës Fundore të Digës në HEC, Koman”.

Në zbatim të pikës dh. neni 4 kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, neni 8 dhe 13, të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshillit Teknik i Përherëshëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2012, mori në shqyrtim projekt-idenë e objektit “Rehabilitimi i Pjesës Fundore të Digës në HEC, Koman”, Projekti u paraqit nga grupi projektues i KESH-it. KKDM mbas pyetjeve e diskutimeve për të,

Vendosi:

Të miratojë projekt-idenë e objektit “Rehabilitimi i Pjesës Fundore të Digës në HEC, Koman”, duke sugjeruar:

- Rrjeshti i parë i pilotave nga ana e biefit të poshtëm në kontakt me ujin të jetë i plotë, me pilota të bashkëngjitura dhe të mbështetur në shkëmbinj rrënjësor.
- Të plotësohet preventivi përfundimtar për të gjitha objektet e projektit “Rehabilitimi i Pjesës Fundore të Digës në HEC, Koman”.
- Të sqarohet se në ç’bazë (ç’raport sizmologjik) janë marrë, vlerat PGA Horiz. =0.448g dhe PGA Vert.=0.3g, si shpejtime llogaritëse për analiza pseudostatike dhe ato dinamike.

Me respekt.

Peri DISHNICA
KRYETAR